

DEKRET
Nr. 451, datë 5.12.2025

PËR DHËNIE DEKORATE

Në mbështetje të nenit 92, germa “ç”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 6, pika 1, të ligjit nr. 93/2022, “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

**Dhënien e dekoratës “Komandar i Urdhrit të Lisit Akademik”
zonjës Etleva Domi**

“Në vlerësim të kontributeve të spikatura e të qëndrueshme në fushën e mësimdhënies dhe formimit akademik, si edhe për merita në modernizimin e Bibliotekës Kombëtare, ku ka punuar me përkushtim dhe me rezultate të lavdërueshme, duke u dalluar për lëvrimin e disiplinës së bibliotekonomisë, për përmirësimin e kushteve të shërbimit të publikut dhe për thellimin e bashkëpunimit ndërkombëtar”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj